



## **Bashkimi Evropian Instrumenti për ndihmën Para- Anëtarësimin Për Zhvillimin Rural – IPARD**

### **NJOFTIM**

Bazuar në rekomandimet e DG-AGRI (Project Manager), sipas email-eve të dërguara nga ana e tyre gjatë periudhës Gusht - Shtator 2019, në ambientet e AZHBR-së është organizuar takim me përfaqësues të Autoritetit Menaxhues dhe AZHBR-së për diskutimin e udhëzimeve të ardhura nga DG-AGRI për çështjen e rregullit të origjinës dhe përmbushjes së standardeve të BE-së për **mjete/makineri bujqësore**.

Problematikat e diskutuara:

- Adresimi i rekomandimeve të DG-AGRI;
- Rregulloret dhe baza ligjore që duhet të aplikohet;
- Kategoria minimale e traktorëve që duhet të pranohen gjatë thirrjes së parë për aplikime (IPARD II);

Gjatë takimit u dakordësua që të bëhet njoftimi në fagen zyrtare të AZHBR, si një nga format më të shpejta të njoftimit të subjekteve/aplikantëve, të cilët kanë aplikuar në Masën 1 të programit IPARD II, në thirrjen e parë, mbyllur më datë 30 Janar 2019, si dhe të gjithë subjekteve, të cilët duan të bëhen pjesë e këtij programi në thirrjet e ardhshme.

Në kuadër të implementimit të programit IPARD II është e domosdoshme që investimet për mjete/makineri bujqësore të përmbushin standardet e BE-së, përsa i përket limiteve të emetimit të gazrave në mjedis. Gjithashtu, pajisjet me vlerë nën 100 000 Euro (që nuk janë pjesë e listës së vendeve të origjinës) duhet të plotësojnë standardet e BE-së në fuqi.

Kategoria minimale e lejuar për motorrët e traktorëve duhet të jetë **të paktën IIIB**.

Të gjithë investimet për traktorë duhet të plotësojnë standardet referuar bazës ligjore më poshtë:

- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 985 e datës 12 Shkurt 2018, që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 167/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me kërkesat mjedisore për

automjetet bujqësore dhe pyjore dhe motorët e tyre dhe shfuqizues i Rregullores së Komisionit (BE) 2015/96;

- Rregullore (BE) 2016/1628 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 14 shtator 2016 për kërkesat në lidhje me kufijtë e emetimit të ndotësve të gaztë dhe grimcave dhe miratimin e tipit për motorrët me djegie të brendshme për makineri lëvizëse jo- rrugore, duke ndryshuar rregulloret (BE) Nr 1024/2012 dhe (BE) Nr 167/2013, dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivës 97/68 / EC;
- Ligji nr. 37/2015 Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare te BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II);
- Marrëveshje Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare te BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër te instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe zhvillimi rural" (IPARD);
- Legjislacioni mjedisor përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe të mjedisit, si dhe standardet themelore të punës të njohura ndërkombëtarisht.